



**KËSHILLI KONSULTATIV  
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE**

Nr. 153 prot

Tiranë, më 25 04 2023.

**VENDIM**

Nr. 3 datë 25/04 2023

**PËR**

**MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E  
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE  
VENDORE TË DATËS 24/4/2023**

Këshilli Konsultativ, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Vendimin Nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për çështjet, objektet konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, objekt konsultimi në mbledhjen e datës 24/4/2023 vendosi:

1. Për projektvendimin "**Për miratimin e rregullorese "Për marrëdhëniet e avokaturës së shtetit dhe personave juridikë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe norma të posaçme procedurale"**", propozuar nga Kryeministria, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
2. Për projektligjin "**Për disa shtesa në Ligjin 9244, datë 17.06.2014, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"**", të ndryshuar, propozuar nga Deputet i Parlamentit Shqiptar, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
  - Neni 1, pika 3, shkronja "a", sugjerohet marrja e lejes nga NJVV që mund të jetë drejtoria/sektori që mbulon çështjet mjedisore në secilën bashki, duke qenë se bashkia përfshin një territor të gjerë, janë Njësitë Administrative që njohin më mirë vendndodhjet e tokave dhe rrezikshmërinë që ato shfaqin në rast të daljes nga kontrolli të zjarrit;

- Neni 1, pika 3, shkronja "b", të shtohet që së bashku me marrjen e lejes nga shërbimet civile të bëhet dhe identifikimi i pajisjes së personit/personave me një mjet (fikës zjarri) i cili do të përdoret në rast të daljes nga kontrolli të zjarrit;
  - Neni 1, pika 5, për distancat e parashikuara duhen të jenë më të largëta pasi në rastet kur marrim parasysh shpejtësinë e përhapjes së flakëve në rastin e daljes nga kontrolli të zjarrit, njoftimi dhe ndërhyrja e autoriteteve nuk mund të kryhet në një kohë aq të shkurtër.
3. Për projektligjin **"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.119, datë 14.09.2014, "Për të drejtën e informimit"**", propozuar nga Ministria e Drejtësisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
- Të vihen detyrime për bashkitë vetëm në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" ose sipas marrëveshjeve që ato lidhin;
  - Pika 1, neni 1, sa herë që ligji nr. 119/2014 përmend "autoriteti publik", në referim të organeve të bashkisë, dispozitat në vazhdim duhet ta reflektojnë këtë fakt;
  - Të sqarohet termi "Interesi i lartë publik" i propozuar si ndryshim i shkronjës II, pas shkronjës I të pikës 1, të nenit 7, "për veprat penale që kanë interes të lartë publik";
  - Të sqarohet termi "Identiteti i kërkuesit të informacionit", neni 8 pika 1, "Identiteti i kërkuesve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër";
  - Pika 6 neni 2, ndryshimet ligjore të parashikojnë se për të gjithë ato autoritete publike që janë objekt i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", koordinatori të jetë nëpunës civil;
  - Neni 3/1 mbi mënyrën e përzgjedhjes së anëtarit nga NJVV për Bordin Këshillimor të Komisionerit të përcaktohet me ligjin 119/2014 dhe jo të bëhet sipas dispozitave të rregullores së miratur nga Komisioneri.
  - Pika iii, shkronja "a" pika 1, neni 7, "Kategoritë e Informacionit" të shtohet: "dhe akteve normative të organeve vendimarrsve";
  - Pika 2, neni 7, të ndryshohet: "si dhe me informacion mbi metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë";
  - Pika 2, neni 7, të shtohet: "Autoriteti publik miraton rregulloren me normat dhe standardet për krijimin, popullimin me të dhëna, operimin, përditësimin, ruajtjen dhe arkivimin e informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, të publikuara në faqen zyrtare të tij në internet";
  - Pika 3, neni 7, të ndryshohet: "brenda 48 orëve prej miratimit të aktit nga autoritetet publike, përveç kur parashikohet ndryshe në ligje të veçanta";
  - Të miratohet veçmas nga të dy organet, Këshilli bashkiak dhe Kryetari i bashkisë regjistri i posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre, drejtuar organeve të NJVV;
  - Në rastin e autoriteteve publike që janë objekt i ligjit për nëpunësin civil, përfshirë NJVV, koordinatori për të drejtën e informimit duhet të jetë nëpunës civil;

- Të ndryshohet "Titullari i autoritetit publik", në rastin e NJVV, Kryetari i NJVV cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit si dhe të shtohet: "Kryetari i NJVV ka detyrimin e njoftimit të menjëhershëm të emërimit apo ndryshimit të koordinorit për të drejtën e informimit pranë Komisionerit";
  - Pas pikës 2, të nenit 10, shtohet pika 3, duhet që procedimi disiplinor ndaj koordinorit bëhet nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (MBNJ), bazuar në ligjin "Për Nënpunësin civil" dhe sipas rregullores së MBNJ të autoritetit publik (psh. NJVV) dhe nuk mund të varet nga miratimi paraprak i Komisionerit, por mund të rekomandojë procedim disiplinor ndaj koordinorit;
  - Të hiqet fjalia "Shërbimet e administratës publike janë pa pagesë" sepse shërbimet ofrohen mbi bazë të tarifave të përcaktuara me ligj;
  - Të rregullohet paragrafi i nenit 14, pika 1 e ligjit sepse nuk përcakton afate;
  - Të rregullohet pika 2, neni 19, si dhe pas pikës 3 të nenit 19, shtohet pika 2/1 "titullari i autoritetit publik mund të delegojë kompetencën e tij" duke patur parasysh se NJVV janë institucione të pavarura sipas ligjit nr. 152/2013 dhe në lidhje me titullarët e autoritetit publik, në rastin e NJVV bazuar në ligjin nr. 139/2015 janë dy organe me drejtuesit përkatës, Kryetari i Këshilli Bashkiak (Legjislativi) dhe Kryetari i Bashkisë (Ekzekutivi);
  - Neni 24, të kihet parasysh se në nenin 13 "Mbikëqyrja dhe kontrolli", ligji 139/2015 nuk parashikon inspektim pranë organeve të NJVV nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit, përveç inspektimit financiar për zbatimin e normave dhe standardeve kombëtare në fushën e menaxhimit të financave publike, sipas legjislacionit në fuqi;
  - Neni 24, pas shkronjës "ç" të pikës 5, të kihet parasysh përcaktimi "vendos për marrjen e masave strukturore". Komisioneri nuk mund të ndërhyjë apo të cënojë autonominë/autoritetin vetëqeverisës të NJVV, përse i përket masave strukturore që ndërmerren nga këto të fundit, por Komisioneri mund të bëjë rekomandime, ndërsa sipas pikës 6, shtohet pika 6/1, Komisioneri nuk duhet të ndërhyjë me vendimmarrjen e tij në autoritetin vetëqeverisës të NJVV duke e përcaktuar vendimin e Komisionerit si titull ekzekutiv.
4. Për projektvendimin "**Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për llojin e dokumenteve, për procedurën administrative të shqyrtimit të kërkesës, mënyrën e pagesës, numrin e ndërtesave për zyrat vendore dhe për kufijtë maksimalë të qirasë për zyrat qendrore dhe vendore të partive politike**", propozuar nga Ministria e Drejtësisë, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;
- Të parashikohen rregulla mbi të drejtën e subjekteve politike që kanë depozituar kërkesën për t'u pajisur me zyra qendrore/vendore dhe për t'u ankuar në rast të refuzimit të kërkesës së tyre nga struktura përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme apo bashki;
  - Të parashikohen struktura përgjegjëse me kompetencën për të shqyrtuar ankimin administrativ dhe gjyqësor si edhe afatet që do të ndiqen në këtë rast;
  - Të qartësohet lidhur me pagesën e qerasë të mbuluar nga shteti për zyrat vendore;

- Neni 11, mbi kërkesën drejtuar Ministrisë së Brendshme apo bashkisë, partia politike të paraqesë kopje të njehsuar jo të të gjitha kontratave të qerasë, por vetëm të asaj për të cilën kërkohet mbulimi i qerasë nga shteti;
  - Pika 13, në kundërshtim me pikën 19, ligji “Për partitë politike” i cili përcakton rregullat mbi mënyrën/formulën e llogaritjes së masës së ndihmës financiare dhe në asnjërin prej tyre nuk parashikohet si kriter marrja në konsideratë e masës për pagimin e qerasë për zyrat qendrore/vendore sipas të gjitha kontratave të qerasë të përcjella nga partitë politike;
  - Të rregullohen afatet e depozitimit të kërkesave nga partitë politike me qëllim që të ketë koherencë me afatet e parashikuara në Kodin Zgjedhor, kur KQZ merr vendimet për shpërndarjen e fondeve vjetore për partitë politike;
  - Kufizon mënyrën se si partitë politike mund ta përdorin fondin e shpërndarë me vendim të KQZ-së të cilët mund të raportojnë mbulimin vetëm të qerasë së një zyre.
5. Për projektvendimin **“Për miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit dhe funksionimit, programet dhe financimin e shërbimit të specializuar për të miturin në konflikt me ligjin”**, propozuar nga Ministria e Drejtësisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Neni 3, pika 3, “kërkesa për 5 vite eksperiencë për personat juridike” është e vështirë për t’u arritur në bashkitë e vogla duke qenë se numri i tyre është i vogël dhe sugjerojmë ti lihet bashkisë;
  - Neni 4, pika 3, “ofruesi i shërbimit”, të përcaktohet kush do ofrojë këtë shërbim;
  - Neni 4, pika 4, “ofruesi i shërbimit për të miturit në konflikt me ligjin”, duhet të ketë një program trajnimi për punonjësit e tij”, meqenëse bashkia e ka të vështirë të plotësojë kushtet e kësaj pike, të bëhen trajnime në nivel qendror;
  - Të paraqitet një tablo nga qendra për të mitur në konflikt me ligjin për të koordinuar me bashkitë në mënyrë që të planifikohet në buxhetin e vitit dhe ana financiare të përballohet nga shteti.
6. Për projektvendimin **“Për miratimin e procedurave për kryerjen e veprimtarive të shfrytëzimit në fondin pyjor kombëtar nga individ apo subjekte të licensuara”**, propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
7. Për projektvendimin **“Mbi përcaktimin e tarifës për të drejtën e kalimit për rrjetet e komunikimeve elektronike dhe te rregullave për mënyrën dhe afatin e pagimit”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
8. Për projektvendimin **“Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të aksesit në infrastrukturë dhe çmimet referuese të aksesit”**, propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.

9. Për projektvendimin **“Për miratimin e dokumentit udhëzues të politikave mbi Zonat e Përcaktuara për Akuakulturë (ZPA) në Shqipëri”**, propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtarët e Këshillit Konsultativ mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
10. Për projektvendimin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.22, datë 12.1.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve e të procedurave për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit dhe ndërtimin e strukturave/objekteve në funksion të tij”**”, të ndryshuar, propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Pika “a”, ndryshon terminologjia e përdorur nga “fermat... e mbjella me kulturë bujqësore” në “fermat... me funksion mbjelljen e kulturave bujqësore”, që mund të mos vijë në përputhje me qëllimin në total të projektvendimit pasi subjektet që kanë në pronësi/përdorim fermat bujqësore mund të certifikohen të zhvillojnë agroturizëm edhe pa i mbjellë kulturat bujqësore, duke u justifikuar lidhur me funksionin që mund të kenë sipërfaqet (1 ha tokë) që mund të kenë në pronësi/përdorim;
  - Pika “c” duke përdorur edhe për njësitë agrikulturore të njëjtat kriterë si për “fermat bujqësore/blegtorale” disfavorizon ata subjekte që ushtronin vetëm përpunimin e produkteve bujqësore/blegtorale;
  - Pika 21/1 i japin fuqi prapavepruese aktit, disavantazhon ata subjekte që kanë plotësuar kushtet/kriteret e legjislacionit në fuqi dhe kanë depozituar të gjithë dokumentacionin për certifikim sipas kriterëve të VKM-së ekzistuese nr.22/2018.
11. Për projektvendimin **“Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025”**, propozuar nga Ministri i Shtetit/Kryenegociator, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të përcaktohet ndërlidhja e PKIE 2023-2025 për detyrimet e bashkive për zbatimin e saj.
12. Për projektvendimin **“Për një ndryshim në vendimin nr.414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”**”, propozuar nga Ministria e Mbrojtjes, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të parashikohen specifikime teknike lidhur me blerjen e automjeteve apo makinave të tjera, në të kundërt krijohen kushte për përdorimin abuziv të këtij fondi në bashki të ndryshme. Në këtë mënyrë, ndryshimi duhet të shihet i lidhur edhe me pikën 3.2 të VKM-së nr. 414/2021;

- Të evidentohen në relacion arsyet që kanë sjellë nevojën për ndryshim si dhe nuk janë pasqyruar problematikat e bashkive lidhur me zbatimin e VKM-së nr.414/2021.

**Znj. Romina KUKO**  
**Zv/Ministër i Brendshëm**  
**Bashkëkryetar**



**Z. Aldrin DALIPI**  
**Kryetar i Shoqatës së**  
**të Qarqeve të Shqipërisë**  
**Bashkëkryetar**

